

Numri: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: **Gjykatësin të Procedurës Paraprake**
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: Mbrojtësi i specializuar për Jakup Krasniqin

Datë: 6 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

I parashtrohet: Gjykatësit të Procedurës Parapake

Kërkesë urgjente për pjesëmarrje përmes videolidhjes në paraqitjen e parë

Zyrës së Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësja e Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

**KËRKESË URGJENTE PËR PJESËMARRJE PËRMES VIDEOLIDHJES NË PARAQITJEN
E PARË**

1. Më datë 4 nëntor 2020 z. Jakup Krasniqi u arrestua dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë të Holandës.
2. Më datë 5 nëntor 2020 Gjykatësi i Procedurës Parapake vendosi mbajtjen e seancës së paraqitjes së parë të z. Krasniqi ditën e hënë, datë 9 nëntor 2020, në orën 11:00.
3. Më datë 6 nëntor 2020 znj. Venkatesvari Alagendra u informua nga Zyra e Mbrojtjes e DHS-së se ishte emëruar si mbrojtëse e z. Jakup Krasniqi nga Administratorja, në orën 7:46 të mbrëmjes sipas orës së Malajzisë.
4. Znj. Venkatesvari Alagendra ndodhet aktualisht në Kuala Lumpur të Malajzisë dhe nuk mund të paraqitet në mjediset e DHS-së brenda orës 11:00 të datës 9 nëntor 2020, një afat i shkurtër ky, duke pasur parasysh edhe kufizimet mbi udhëtimet/lëvizjet të lidhura me COVID-19 të cilat janë aktualisht në fuqi në Malajzi.
5. Parashtruesja e kërkesës me respekt dhe me urgjencë kërkon që mbrojtëses t'i jepet leje të marrë pjesë në paraqitjen e parë përmes videolidhjes prej Kuala Lumpurit të Malajzisë, për të bërë parashtrimet e nevojshme me gojë, siç kërkohet nga DHS-ja në vendimin e datës 6 nëntor 2020.

Numri i fjalëve (në origjinal): 246

/nënshkrimi/

VENKATESVARI ALAGENDRA

Mbrojtëse e specializuar e z. Jakup Krasniqi

6 nëntor 2020

Kuala Lumpur, Malajzi